

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-94/021	Data: Datum: 01.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesat: Nr.01-016-10825 të datës 04.05.2020; Nr.01-016-1780, të datës 14.01.2021; Nr.01-016-016-10164 të datës 18.03.2021; Nr.01-016-6445 të datës 18.02.2021, të parashtruara nga "OVL-UÇK" në Istog, për përkrahje me karburant për nevojat e tyre dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHEN:** kërkesat Nr.01-016-10825 të datës 04.05.2020; Nr.01-016-1780, të datës 14.01.2021; Nr.01-016-016-10164 të datës 18.03.2021; Nr.01-016-6445 të datës 18.02.2021, të parashtruara nga "OVL-UÇK", për përkrahje me karburant dhe përkrahet me nga 50 litra karburant për nevojat të "OVL-UÇK-së" për sejcilën kërkesë nga 50 litra gjithsejtë 150 litra karburant.
2. Obligohet Zyrtari i Transportit, përfaqësuesin e "OVL-UÇK" të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

"OVL-UÇK", ka parashtruar kërkesat Nr.01-016-10825 të datës 04.05.2020; Nr.01-016-1780, të datës 14.01.2021; Nr.01-016-016-10164 të datës 18.03.2021; Nr.01-016-6445 të datës 18.02.2021, për përkrahje me karburant për nevojat të këtij Institucioni.

Kryetari shqyrtoi kërkesën OVL-UÇK", dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton dhe përkrahet me nga 50 litra karburant për nevojat të "OVL-UÇK-së" për sejcilën kërkesë nga 50 litra gjithsejtë 150 litra karburant.

Zyrtari i Transportit do ti pajisë me vërtetim për furnizim me karburante të lartpërmendurit nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Shefi i Autoparkut kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: "OVL-UÇK", Zyrtari i Transportit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-95/2021	Data: Datum: 02.04.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Larja dhe Fshirja e Rrugëve në Zonat Urbane" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1066-221 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-008-221, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Larja dhe Fshirja e Rrugëve në Zonat Urbane" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1066-221 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-008-221 dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar dhe
- 1.3. **Sadik Kovačević**, Komandant i Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Larja dhe Fshirja e Rrugëve në Zonat Urbane" si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.98/021	Data: 07.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj lajmërimin 02 Nr.16/021 të datës 01.04.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për pagesën e një page mujore me përfundimin e shërbimit-pensionimit të Rexhep Osmanaj, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Zyrtar për Zhvillim, nxjerr:

V E N D I M

- KOMPENZOHE**: Rexhep Osmanaj, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Zyrtar për Zhvillim në Drejtorinë për Administratë Komunale, në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar, për shkak të pensionimit.
- Nëpunësit civil të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **29.03.2021**.
- Pagesa e mjeteve të cekura në pikën 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Administratë Komunale.
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa obligohet të bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Personelit.
- Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Rexhep Osmanaj**, Drejtoria për Administratë Komunale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Personelit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-99/2021	Data: Datum: 07.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 60 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019), nenin 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenin 22 paragrafi 1 të Rregullore Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj lajmërimin 02 Nr.16/021 të datës 01.04.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për pagesën e një page mujore me bashkëshortes së Bedri Hajzeraj për përfundimin e shërbimit me vdekje, ish nëpunës civil, titulli i vendit të punës: Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Rini dhe Sport, nxjerr:

V E N D I M

1. **KOMPENZOHE**: Hysnije Hajzeraj bashkëshortja e Bedri Hajzeraj, ish nëpunës civil, në lartësi prej një page mujore të cilën aji e ka realizuar para vdekjes, sipas nenin 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 paragrafi 1 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil.
2. Nëpunësit civil të lartpërmendur i përfundon shërbimi me vdekjen e tij nga data **31.03.2021**.
3. Pagesa e mjeteve të cekura në pikën 1. e këtij Vendimi, do të bëhet në xhirollogarinë e Hysnije Hajzeraj nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Drejtoria për Buxhet dhe Financa obligohet të bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Personelit.
6. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Hysnije Hajzeraj**-bashkëshortja, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Personelit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-100/021	Data: Datum: 07.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-5355, të datës 09.02.2021, e parashtruar nga z.Sabri Kelmendi, nga fsh.Zallq, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-5355, të datës 09.02.2020 e parashtruar nga z.Sabri Kelmendi, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 300€(treqindë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Sabri Kelmendi, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Sabri Kelmendi, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-5355, të datës 09.02.2020, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.
 Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Sabri Kelmendi është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim. Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.
 Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Sabri Kelmendi në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.
 Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
 Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Sabri Kelmendi, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
 Halil RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-101/2021	Data: Datum: 07.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nënin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e datës 07.04.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: "Trajtimi, kastrimi dhe sterilizimi i qenve endacak", nxjerr:

V E N D I M

- CAKTOHET:** Menaxher i kontratës, **Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Enver Rugova**, Drejtor i D.SH.P.M.SH për projektin: "Trajtimi, kastrimi dhe sterilizimi i qenve endacak" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-620-2-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-004-221, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori Haki Bytyçi B.I. nga Istogu.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Hekuran Rugova, Enver Rugova, Haki Bytyçi B.I, Prokurimi** dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Zyrtari Kryesor Administrativ
z. Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-102/2021	Data: Datum: 08.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e datës 08.04.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: "Furnizimi me medikamente për nevoja të QKMF-së", nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxhere e kontratës, **Arbnore Maxharraj**, Farmaciste, në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqene Sociale dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxheres së kontratës **Mujë Osmanaj**, Drejtor i D.SH.M.S për projektin: "Furnizimi me medikamente për nevoja të QKMF-së", me numër të jashtëm prokurimi 633-021-819-1-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-006-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori Shefqet Mehmetukaj B.I. nga Prishtina.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Arbnore Maxharraj, Mujë Osmanaj, Shefqet Mehmetukaj B.I, Prokurimi** dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-103/021	Data: Datum: 08.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-12605 të datës 08.04.2021 të parashtruar nga Arsim Berisha nga fshati Staradan, Komuna e Istogut, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së prindërit-babait (Xhafer Berishaj), dhe nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-120-12605 e datës 08.04.2021, e parashtruar nga Arsim Berisha, Zyrtar për Kadastër, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes e babait (Xhafer Berishaj) dhe i ndahen mjetet financiare në shumën prej **389.20 €** (treqind e tetëdhjetë e nëntë euro e njëzet cent) nga nënprogrami buxhetor të Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi, kategoria ekonomike paga dhe mëditje kodi ekonomik 11155-shtesat dhe kompensimet tjera (vendim) si ndihmë për familjen e të lartpërmendurit.
- Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Arsim Berisha, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Arsim Berisha, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	Nr.Br. 01-104/2021	Data: Datum: 08.04.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), nenit 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, nxjerr:

V E N D I M

1. **SHKARKOHET** nga detyra Valmir Loxha, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës, fizioterapeut i diplomuar, nga fsh. Banjë.
2. Me datën 01.04.2021, zyrtarit të lartpërmendur i ndërpritet marrëdhënia e punës me shkarkim nga detyra në bazë të nenit 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna.
1. Drejtoria për Buxhet dhe Financa obligohet të bëjë kërkesë në Ministrinë kompetente që **Valmir Loxha**, të largohet nga lista e pagave.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Personelit.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: **Valmir Loxha**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Personelit, dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



KRYETARI I KOMUNËS
Haki RUGOVA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA ISTOG/ OPŠTINA ISTOK/ MUNICIPALITY OF ISTOK

Nr. 01-106/2021

Datë: 12.04.2021

Komisioni Komunal për Riintegrim , sipas Rregullores QRK nr. 22/2020, bazuar në nenin 44, paragrafi 1, 4, nën paragrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 1, 2 dhe 4, neni 33, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 dhe 1.11, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegritimit, mbështetur ne Vendimin Kryetarit te Komunës për themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, në harmoni me Ligjin Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e **Hysni Braimaj** e riatdhesuar nga **Gjermania** me datë **08.03.2021** për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit për akomodim me qira për **12** muaj, në vlerë prej **200.00€** Euro në muaj, duke i përfshirë edhe shpenzimet komunale, sipas kërkesës me Nr **10-553-11471** të datës **31.03.2021** të parashtruar në Komunën e **Istogut**.
2. Përfitues nga pika 1 e këtij vendimi është familja **(4)** anëtarëshe nga komuna e **Istogut**
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Ministria e Punëve te Brendshme.
4. Për ekzekutimin e pagesës së qirasë sipas këtij Vendimi Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Komunal për Riintegrim , në seancën e mbajtur më datë **08.04.2021**, ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar me datë **31.03.2021** nga e riatdhesuara **Hysni Braimaj** në Komunën e **Istogut** për përfitim nga Masat Emergjente të Riintegritimit për akomodim me qira.

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuara dhe sipas dëshmive të paraqitura, konstaton se e riatdhesuara i **plotëson** kriteret për mbështetje nga Masat Emergjente të riintegritimit të për akomodim me qira duke filluar nga data **15.04.2021 deri me 15.04.2022**, të përcaktuara me Rregulloren QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, neni 44, paragrafi 1, 4,

nën paragrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 1, 2 dhe 4, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas pranimi të tij, mund të paraqes ankesë në Komisionin e Ankesave .

Istog, më 12.04.2021

Kopja e vendimit i dërgohet:

Arkivit të Komunës .

Zyrës Komunale për Komunitete dhe Këthim

Zyrtarit për Koordinim Rajonal të MBP

Ministrit të Ekonomisë dhe Ambientit

Personit të riatdhesuar



z. Haki Rugova

Kryetar i Komunës së Istogut

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-107/2021	Data: Datum: 13.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-12674, të datës 08.04.2021, të parashtruar nga z.Agim Ahmetaj, nga fsh.Bellopojë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-12674, të datës 08.04.2021 e parashtruar nga z.Agim Ahmetaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e tij në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore(Radioterapisë) dhe i lejohen 100 litra karburant.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Agim Ahmetaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Agim Ahmetaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-12674, të datës 08.04.2021, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se z.Agim Ahmetaj, është i sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për në Prishtinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Agim Ahmetaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkhiv të Zyres së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-110/2021	Data: Datum: 16.04.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektet: Lot1 "Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës ne SHFMU "Martin Camaj"-Paralelja e ndare ne Llukac te Thate" Lot2-Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës ne SHFMU dhe infrastrukturës në SHFMU "Fan Noli"-Paralelja e ndare ne Dobrushë, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1310-5-2-1 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-010-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektet: Lot1 "Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës ne SHFMU "Martin Camaj"-Paralelja e ndare ne Llukac te Thate" Lot2-Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës ne SHFMU dhe infrastrukturës në SHFMU "Fan Noli"-Paralelja e ndare ne Dobrushë, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1310-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-010-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Hekuran Rugova,** Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Naim Sadriu,** Zyrtar për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim anëtar dhe
- 1.3. Shefqet Imeraj,** Zyrtar i Prokurimit 2, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektet: Lot1 "Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës ne SHFMU "Martin Camaj"-Paralelja e ndare ne Llukac te Thate" Lot2-Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës ne SHFMU dhe infrastrukturës në SHFMU "Fan Noli"-Paralelja e ndare ne Dobrushë, si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektet e lartcekura e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria Komunalë për Arsim.

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria Komunale për Arsim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-109/2021	Data: Datum: 16.04.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Mirëmbajta e Stadiumit të Qytetit në Istog" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1906-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-014-136, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Mirëmbajta e Stadiumit të Qytetit në Istog" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1906-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-014-136 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Naim Sadriu,** Zyrtar për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Qefsere Ibrahimaj,** Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Kulturore dhe Arkiv të Qytetit, anëtare dhe
- 1.3. Naser Gjoci,** Inxh. i ndërtimit, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Mirëmbajta e Stadiumit të Qytetit në Istog" si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Flaki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-111/2021	Data: Datum: 16.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-13280, të datës 14.04.2021, të parashtruar nga znj.Leonita Madanaj, nga fsh.Saradran, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënës së saj në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-13280, të datës 14.04.2021, e parashtruar nga znj.Leonita Madanaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënës së saj në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore (Kimioterapisë) dhe i lejohen 300 litra karburant.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë znj.Leonita Madanaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

znj.Leonita Madanaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-13280, të datës 14.04.2021, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Zyra Januzaj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për në Prishtinë për marrjen e terapisë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: znj.Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-112/2021	Data: Datum: 16.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 12 par 12.3 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.04/L-081, nenin 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2011 për punët dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpinë me bazë në komunitet, Komisioni i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për shqyrtimin e kërkesave dhe pranimin e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Gurakoc, shqyrtoi kërkesën Nr.06-016/12723, të datës 08.04.2021, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Istogut, për lejimin e strehimit të përherëshëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për znj.Fatime Maxharraj nga fshati Cerrcë, Komuna Istog dhe i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-016/12723, të datës 08.04.2021, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Istogut, për lejimin e strehimit të përherëshëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për znj.Fatime Maxharraj, me nacionalitet shqiptar, me shtetësi kosovare e lindur me 14.04.1935, në fshatin Lubozhdë komuna Istog.
2. Komisioni për rastin në fjalë ka vendos ti lejoj strehimin e përherëshëm te te lartcekurës.
3. Shtëpia e Komunitetit në Gurakoc është përgjegjëse për përkujdesjen ndaj znj.Fatime Maxharraj, gjatë qëndrimit në këtë institucion.
4. Obligohet Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së që të përcjell dhe të mbikqyrë gjendjen e klientit në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc.
5. Vendimi është përfundimtar.

Arsyetim

Komisioni i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shqyrtoj, kërkesën Nr.06-016/12723, të datës 08.04.2021, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale në Istog, për strehimin e të moshuarëve, shqyrtoi dosjen e znj.Fatime Maxharraj e cila jeton në fsh.Cerrcë" në shtëpi të ish-bashkëshortit, jeton në një dhomë të veçant ka edhe një banjo në shfrytëzim pra ajo jeton e vetëm pa përkujdesje nga askush. Gjendja shëndetësore e saj për momentin është e mirë pa probleme mendore, statusi familjar nuk ka bashkëshort, fëmijë biologjik as të adoptuar nuk ka vëllezër dhe as motër, ka qenë fëmija i vetëm në shtëpi pas vdekjes së prindërve, por që ka pasur martesë të mëhershme disa here, por të gjitha pa fëmijë. Komisioni për rastin në fjalë ka vendos në mënyrë të përherëshme vendosjen e saj pas shqyrtimit të dosjes dhe gjendjes shëndetësore të saj, me ç'rast ka konstatuar se duhet t'i lejohet strehimi institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc. Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: znj.Fatime Maxharraj, Haki Ibrahimaj-Drejtor i QPS-së në Istog, Menaxheri i shtëpisë së komunitetit në Gurakoc dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-113/2021	Data: Datum: 19.04.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektet: Lot1 "Betonimi i Kanalit të Ujitjes në Dubovë"; Lot2 "Betonimi i Kanalit të Ujitjes Termal Onix-Corrollukë"; Lot3 "Betonimi i Kanalit Dobrushë-Lubovë"; Lot4 "Rregullimi i Përroit Vërshues në Kaliqan" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1265-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-009-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektet: Lot1 "Betonimi i Kanalit të Ujitjes në Dubovë"; Lot2 "Betonimi i Kanalit të Ujitjes Termal Onix-Corrollukë"; Lot3 "Betonimi i Kanalit Dobrushë-Lubovë"; Lot4 "Rregullimi i Përroit Vërshues në Kaliqan" me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1265-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-009-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Naser Gjoci, Inxh. i ndërtimit, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Xhevat Idrizaj, Zyrtar për Pylltari 2
- 1.3. Driton Alihajdaraj, Zyrtar i prokurimit 2, anëtar dhe

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektet: Lot1 "Betonimi i Kanalit të Ujitjes në Dubovë"; Lot2 "Betonimi i Kanalit të Ujitjes Termal Onix-Corrollukë"; Lot3 "Betonimi i Kanalit Dobrushë-Lubovë"; Lot4 "Rregullimi i Përroit Vërshues në Kaliqan" si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektet e lartcekura e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Bujqësi , Pylltari dhe Hidroekonomi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-116/021	Data: Datum: 19.04.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim shqyrtoj kërkesën Nr.08-352-10368 të datës 22.03.2021 të parashtruar nga Nazmi Gorani, nga Istogu, Komuna e Istogut, për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga era dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.08-352-10368 të datës 22.03.2021 të parashtruar nga Nazmi Gorani, për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga era të cilit ju ka dëmtuar kulmi i shtëpisë dhe i ndahen **1,350.00€ (një mijë e trëqind e pesdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Nazmi Gorani, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Nazmi Gorani ka parashtruar kërkesën Nr.08-352-10368 të datës 22.03.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga era të cilit ju ka dëmtuar kulmi i shtëpisë. Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga era dhe të njëjtin e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni ka dalur në vendin e ngjarjes ka vlerësuar dëmin e shkaktuar dhe ka dal me vlerësimin e dëmit të shkaktuar dhe perkrahjet mjete financiare në shumë prej **1,350.00€ (një mijë e trëqind e pesdhjetë euro)**. Nga shkresat e lendes shihet se Nazmiut ju është dëmtuar çatija e kulmit të shtëpisë dhe një pjesë e kulmit ju ka ra në oborr.

I lartëpërmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomiko sociale dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë ndërtimin e kulmit.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për perkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen; Nazmi Gorani, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-117/021	Data: Datum: 20.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesat: Nr.01-400-11671 të datës 01.04.2021; Nr.01-016-13381, të datës 15.04.2021; të parashtruara nga "OVL-UÇK" në Istog, për përkrahje me karburant për nevojat e tyre dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHEN:** kërkesat Nr.01-400-11671 të datës 01.04.2021; Nr.01-016-13381, të datës 15.04.2021, të parashtruara nga "OVL-UÇK", për përkrahje me karburant për nevoja të "OVL-UÇK-së dhe përkrahet me nga 50 litra karburant.
2. Obligohet Zyrtari i Transportit, përfaqësuesin e "OVL-UÇK" të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

"OVL-UÇK", ka parashtruar kërkesat Nr.01-400-11671 të datës 01.04.2021; Nr.01-016-13381, të datës 15.04.2021, për përkrahje me karburant për nevoja të këtij Institucioni.

Kryetari shqyrtoi kërkesat e OVL-UÇK", dhe të njëjtat i konsideron të arsyeshme dhe i miraton.

Duke parë rendësin e punës së të lartpërmendurve përkrahen me 50 litra karburant për nevoja të "OVL-UÇK-së" për të dy kërkesat.

Zyrtari i Transportit do ti pajisë me vërtetim për furnizim me karburante të lartpërmendurit nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Shefi i Autoparkut kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: "OVL-UÇK", Zyrtari i Transportit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-118/021	Data: Datum: 19.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) në bazë të nenit 38 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrat e Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 8/2019) dhe nenin 46 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-22/2021 të datës 19.04.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa me Nr.02-22/2021 e datës 19.04.2021 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, për intervistimin me gojë të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin Udhëheqës i Sektorit për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete të publikuar me datën 16.03.2021 në Drejtorinë për Administratë Komunale dhe KVLBK formohet me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. **Xhevahire Avdijaj**, Udhëheqëse e Sektorit të Arkivit, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. **Fatmir Bytyçi**, Menaxher i Personelit, anëtar;
- 1.3. **Haki Ibrahimaj**, Drejtor i Qëndresë për Punë Sociale, anëtar;
- 1.4. **Hatixhe Arifaj**, Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, anëtare dhe
- 1.5. **Rasim Mahmutović**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar.

2. KVLBK zëvendësues është në këtë përbërje si me poshtë:

- 2.1. **Jehona Arifaj**, Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime me Qytetar, Kryesuese e Komisionit;
- 2.2. **Agim Haxhiu**, Drejtor i Qendrës Kulturore, anëtar;
- 2.3. **Zize Bujupaj**, Udhëheqëse e Prokurimit, anëtare;
- 2.4. **Muhamet Gusturanaj**, Udhëheqës i Sektorit për Integrim Evropian, anëtar;
- 2.5. **Fazli Stollaj**, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Administrative, anëtar.

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L - 114 për Zyrat e Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: Komisioni, Komisioni Zëvendësues, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ**

Zekije SUTAJ



**Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA**

Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-119/2021	Data: Datum: 21.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për realizimin e Marrëveshjes Nr.01-115/2021 të datës 19.04.2021 me komunitetin e fsh. Shushicë për realizimin e projektit “Ndërtimi i rrugës malore Shushicë-Kusharishtë” me participim, nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës, **Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Hysni Maxharraj**, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për realizimin e Marrëveshjes Nr.01-115/2021 të datës 19.04.2021 me komunitetin e fsh. Shushicë për realizimin e projektit “Ndërtimi i rrugës malore Shushicë-Kusharishtë” me participim.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Naser Nimanaj**, **Hysni Maxharraj**, N.P.T “Agro Luani”, **Prokurimi** dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.


 Zyrtari Kryesor Administrativ
Z. Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-124/2021	Data: Datum: 26.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e datës 08.04.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Ndërtimi i deponisë në Tuçep”, nxjerr:

V E N D I M

- 1. ÇAKTOHET:** Menaxher i kontratës, **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe **ÇAKTOHET:** Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës **Enver Rugova**, Drejtor i D.SH.P.M.SH për projektin: “Ndërtimi i deponisë në Tuçep”, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-597-5-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-003-521, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori KBC Grup SH.P.K nga Prishtina.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjës për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Naser Gjocaj**, **Enver Rugova**, **KBC Grup SH.P.K** dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Zyrtari Kryesor Administrativ
Enver RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-125/2021	Data: Datum: 29.04.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën Nr.08.51/2021 të datës 29.04.2021 të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për ndarjen e mjeteve buxhetore për hapjen e tenderit për projektin “Sanimi i gjendjes nga fatkeqësitë natyrore”, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.08.51/2021 e datës 29.04.2021 e parashtruar nga Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për ndarjen e mjeteve buxhetore për hapjen e tenderit për projektin “Sanimi i gjendjes nga fatkeqësitë natyrore” dhe ndahen mjete financiare në shumë prej 10,000.00(dhjetëmijë euro) nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim; 25,000.00€ (njëzetepesëmijë euro) nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; 10,000.00 (dhjetëmijë euro) nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe 5,000.00€ (pesëmijë euro) nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime nga programi buxhetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
2. Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, obligohet të përgatitë materialin për hapjen e tenderit për projektin “Sanimi i gjendjes nga fatkeqësitë natyrore”.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Me kopje të Vendimit të njoftohet: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Prokurimi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-131/021	Data: Datum: 30.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) në bazë të nenit 38 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 8/2019) dhe nenin 46 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-25/2021 të datës 29.04.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa me Nr.02-25/2021 të datës 29.04.2021 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, për intervistimin me gojë të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin Udhëheqës i Sektorit për Arsim të publikuar me datën 25.03.2021 në Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe KVLBK formohet me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. Agim Haxhiu,** Drejtor i Qendrës Kulturore, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Fatmir Bytyçi,** Menaxher i Personelit, anëtar;
- 1.3. Haki Ibrahimaj,** Drejtor i Qëndresë për Punë Sociale, anëtar;
- 1.4. Hatixhe Arifaj,** Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, anëtare dhe
- 1.5. Rasim Mahmutović,** Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar.

2. KVLBK zëvendësues është në këtë përbërje si me poshtë:

- 2.1. Jehona Arifaj,** Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime me Qytetar, Kryesuese e Komisionit;
- 2.2. Xhevahire Avdijaj,** Udhëheqëse e Sektorit të Arkivit, anëtare;
- 2.3. Florije Bytyçi,** Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët, anëtare;
- 2.4. Muhamet Gusturanaj,** Udhëheqës i Sektorit për Integrim Evropian, anëtar;
- 2.5. Fazli Stollaj,** Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Administrative, anëtar.

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: Komisioni, Komisioni Zëvendësues, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-126/2021	Data: Datum: 29.04.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: “Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1831-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-013-221, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1831-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-013-221 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Rustem Gashi,** Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim, anëtar dhe
- 1.3. Hekuran Rugova,** Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: “Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal” si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-128/2021	Data: Datum: 30.04.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: "Mirëmbajtja e Rrugëve Lokale te Rendit te IV-te", nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës, **Naser Nimanaj**, Zyrtar i lartë për infrastrukturë rrugore, në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Enver Rugova**, Drejtor i D.SH.P.M.SH për projektin: "Mirëmbajtja e Rrugëve Lokale te Rendit te IV-te", me numër të jashtëm prokurimi 633-021-862-1-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-002-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori "Te Aleni" SH.P.K nga Istogu.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Naser Nimanaj**, **Enver Rugova**, operatori "Te Aleni" SH.P.K dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ


